REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr.3357/7 **Prot.** **Patos më** 03 **.11.2026.**

PROCESVERBAL

MBI MIRATIMIN E RENDIT TË DITËS SË MBLEDHJES SË DATËS 29.10.2026

I mbajtur sot më datë 29.10.2026 në orën 14:00 në sallën e mbledhjeve të Këshillit ku zhvillohet mbledhja e Këshillit të Bashkisë:

Prezent në fillimin e mbledhjes këta këshilltare:

1. Albiona Lamaj
2. Klaudio Alisinanaj
3. Lori Musaj
4. Artan Velçani
5. Armand Ahmetaj
6. Ertila Myrtaj
7. Suela Hoxhaj
8. Smerald Hazizaj
9. Renaldo Shpata
10. Vjollca Kasaj
11. Shezai Sinanaj

Takimi hapet nga kryetari i Këshillit z. Armand Ahmetaj.
Të nderuar qytetarë, anëtarë të Këshillit Bashkiak,
Mbledhja bazohet dhe zhvillohet në bazë të nenit 53 pika 4 neni 56 pika 2 gërma a të ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore".
Lexojmë rendin e ditës
1- Miratimi i rendit të ditës.
2- Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Këshillit datë 09.10.2026.
3- Informacion mbi vendimet e miratuara në mbledhjen e datës 09.10.2026
4- Projekt-vendim "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin Shtator 2026".
5- Projekt-vendim "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin Shtator 2026".
6- Projekt-vendim "Për dhënien e dakordësisë për lidhjen e kontratës noteriale për z. Petrit Mahmutaj".

7- Projekt-vendim "Për miratimin e dhënies së ndihmës financiare nga "fondi i kushtëzuar i buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile", për z. Agur Alushaj banesa e të cilit është dëmtuar nga renia e zjarrit, lagjja 29 Marsi".
Armand Ahmetaj- Keni ndonjë propozim për të shtuar apo për të hequr?
Albiona Lamaj- Si pjesë e komisionit të Shëndetësisë por edhe në profesionin e mjekes ne na ka ardhur në këshill një kërkes nga z. Neim Ballaxhia dhe duke e parë rastin si urgjencë kërkojmë që kjo kërkesë të kaloj në këtë mbledhje të këshillit nëse të gjithë anëtaret e tjerë janë dakord.
Armand Ahmetaj- Kush është dakord ta shtojmë si shtesë kërkesën e z. Neim Ballaxhia në rendin e ditës ?
Miratohet me 11 vota pro, asnjë abstenim, asnjë kundër. Miratohet futja e kërkesës së z. Neim Ballaxhia në rendin e ditës për shqyrtim si pika 8 e këtij rendi.

Kush është dakord me rendin e ditës në tërësi?

Miratohet me 11 vota pro, asnjë abstenim, asnjë kundër.

SEKRETARE
Refaela Xeba

KRYETAR
Armand Ahmetaj

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr.3354/8 Prot. **Patos më 03 .11.2026**

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 29.10.2026 në orën 14:00 në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së dytë të rendit të ditës.

Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Këshillit datë 09.10.2026

Armand Ahmetaj – Procesverbalin si material e keni pasur. Keni ndonjë verejtje, ndonjë kërkesë për korrigjimin e procesverbalit?

Nëse nuk keni, atëherë konsiderohet i miratuar si pelqim unanim

SEKRETARE
Refaela Xeba

Lori Musaj
Smeraldi Hoxha
Rendida Ylyeta

KRYETAR
Armand Ahmetaj

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 3357/9 **Prot.** **Patos më,** 03 **11.2026**

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 29.10.2026 në orën 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së tretë të rendit të ditës.

Mbi informacionin për vendimet e miratuara në mbledhjen e datës 09.10.2026

Armand Ahmetaj– Fjala për Refaelën
Refaela Xeba -Përshëndetje të gjithëve!
Në mbledhjen e datës 09.10.2026 u mor gjithsej 1 vendim, Vendimi Nr. 61. Vendimi nr. 61 i është përcjell Prefekturës për verifikim dhe na ka ardhur përgjigja se është në përputhje me ligjin
Ky vendim i është përcjell drejtorisë përkatëse për ekzekutim.
Faleminderit!

SEKRETARE
Refaela Xeba

Loni Musaj
Smerdol Haderi
Renalda Shpetar

KRYETAR
Armand Ahmetaj

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr.3345/3 **Prot.** **Patos më**03 **11.2026.**

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 29.10.2026 në orën 14:00 në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së katërt të rendit të ditës.

Projekt-vendim "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin Shtator 2026".

Mitjon Nikolla – projektvendim nr. 58 datë 16.10.2026 "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin shator 2026".

Drejtoria e Mbrojtjes Sociale, Arsimit, Kulturës dhe Sportit, Sektori i Shërbimit Social propozon të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondet e buxhetit vendor për muajin Shtator 2026 gjithsej 19 familje me një fond prej 73,890 (shtatëdhjetë e tre mijë e tetëqind e nëntëdhjetë) lekë.

Lori Musaj- Komisioni ekonomisë u mblodh ditën e djeshme dhe ka diskutuar mbi këtë pikë e cili është argumentuar në përputhje me bazën ligjore dhe e kemi votuar pa asnjë ndryshim me tre vota pro.

Armand Ahmetaj –Nëse s'kemi pyetje të tjera unë propozoj ta kalojmë në votim.

Kush është dakord me projektvendimin ?

Miratohet me 11 vota pro, abstenim ska, kundër ska.

SEKRETARE
Refaela Xeba

Lori Musaj Mus
Smerold Hoti
Renaldo Ilyato

KRYETAR
Armand Ahmetaj

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr.3346 Prot. **Patos më 03 11.2026.**

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 29.10.2026 në orën 14:00 në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së pestë të rendit të ditës.

Projekt-vendim "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin shtator 2026".

Mitjon Nikolla – projektvendim nr. 59 datë 16.10.2026 "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin shtator 2026".

Drejtoria e Mbrojtjes Sociale, Arsimit, Kulturës dhe Sportit, Sektori i Shërbimit Social propozon të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondet e kushtëzuara 6% për muajin Shtator 2026 gjithsej 16 familje me një fond prej 62,899 (gjashtëdhjetë e dy mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e nëntë) lekë.

Lori Musaj- Komisioni ekonomisë u mblodh ditën djeshme dhe është diskutuar mbi këtë pikë e cili është argumentuar në përputhje me bazën ligjore dhe e kemi votuar me tre vota pro.

Armand Ahmetaj –Nëse s'kemi pyetje të tjera unë propozoj ta kalojmë në votim pikën e pestë. Kush është dakord?

Miratohet me 11 vota pro, abstenim ska, kundër ska

SEKRETARE
Refaela Xeba

Lori Musaj
Smerald Hoxha
Renalda Shpata

KRYETAR
Armand Ahmetaj

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 3356/3 **Prot.** **Patos më** 03 **11.2026.**

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 29.10.2026 në orën 14:00 në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së gjashtë të rendit të ditës.

Projekt-vendim "Për dhënien e dakordësisë për lidhjen e kontratës noteriale për z. Petrit Mahmutaj".

Arben Shpërdheja- Në mbështetje të nenit 54 të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar; ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992, "Për privatizimin e banesave shtetërore", i ndryshuar; ligjit nr. 9321, datë 25.11.2004, "Për privatizimin e banesave dhe objekteve të kthyera në banesa, të ndërtuara me fondet e shoqërive dhe ndërmarrjeve shtetërore"; ligjit nr. 22/2018, "Për strehimin social", i ndryshuar; si dhe kërkesës me nr. 2511 prot., datë 30.07.2026, të znj. Venetike Mahmutaj, banuese në lagjen "Naftëtari", Komisioni i Privatizimit të Banesave, i ngritur me urdhrin nr. 24, datë 22.01.2026, me nr. 264 prot., datë 22.01.2026, pasi shqyrtoi dokumentacionin e depozituar pranë Bashkisë Patos, vërejti se:

Z. Petrit Mahmutaj ka lidhur kontratë për privatizimin e banesës më datë 13.12.1993 me Ndërmarrjen Komunale Banesa, sipas formularit nr. 3. Banesa ndodhet në lagjen "Naftëtari", në Bashkinë Patos, në pallatin parafabrikat, shkalla 3, kati i 5-të, dhe përbëhet nga 2 dhoma dhe një kuzhinë me aneks, e kategorisë së tretë. Apartamenti është ndërtuar në vitin 1992. Shtesë anësore dhe shtesë kati nuk ka. Këto të dhëna janë sipas formularëve nr. 2 dhe nr. 3 të privatizimit.

Sipas formularit nr. 2 të përllogaritjes, qytetari z. Petrit Mahmutaj ka paguar vlerën prej 18 933 (tetëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e tridhjetë e tre) lekësh. Z. Petrit Mahmutaj e ka shlyer vlerën e mësipërme në mënyrë të menjëhershme, me mandat arkëtimin nr. 3294, datë 13.12.1993.

Në dokumentacionin shoqërues ndodhen akti i dhënies dhe i marrjes në dorëzim të banesës shtetërore, me të dhëna teknike, autorizimi, vërtetimi që banesa ka qenë në dispozicion të ndërmarrjes komunale, certifikata familjare, datë 01.12.1992, kërkesa në formë deklarate, plani i vendosjes, planrilevimi, si dhe formularët nr. 2 dhe nr. 3.

Bazuar në shkresën e ardhur nga ASHK Fier me lëndë "Kthim përgjigje", më datë 14.07.2026. Aneksin 13, aplikuar me nr. 18674, datë 03.07.2026, ku përcaktohet se për të vijuar me shërbimin e pajisjes me certifikatë pronësie, duhet të rilidhni edhe njëherë kontratën e privatizimit me palë Bashkinë Patos.

Komisioni i Privatizimit, pasi shqyrtoi gjithë dokumentacionin e paraqitur nga z. Petrit Mahmutaj, i kërkon Këshillit Bashkiak :

1. Dhënien e dakordësisë për lidhjen e kontratës noteriale për z. Petrit Mahmutaj.
2. Autorizimin e Kryetarit të Bashkisë për nënshkrimin e kontratës noteriale

Klaudio Alisinanaj - Komisioni i Ligjeve u mblodh në datën 28 tetor dhe dhe e kemi me katër vota pro.

Armand Ahmetaj –Nëse s'kemi pyetje të tjera unë propozoj ta kalojmë në votim pikën e gjashtë

Armand Ahmetaj – Kush është dakord?

Miratohet me 11 vota pro, abstenim ska, kundër ska

SEKRETARE
Refaela Xeba

KRYETAR
Armand Ahmetaj

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr.3369/1 Prot. **Patos më 03 11.2026.**

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 29.10.2026 në orën 14:00 në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së shtatë të rendit të ditës.

Projekt-vendim "Për miratimin e dhënies së ndihmës financiare nga "fondi i kushtëzuar i buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile", për z. Agur Alushaj banesa e të cilit është dëmtuar nga renia e zjarrit, lagjja 29 Marsi".

Arben Shpërdheja - Znj. Manushaqe Alushaj ka paraqitur kërkesën me nr. 3369 prot., datë 19.10.2026, për verifikimin e dëmeve të shkaktuara në banesë në lagjen "29 Marsi" nga rënia e zjarrit dhe për ndihmë financiare për rehabilitimin e saj. Për verifikimin e kërkesës së qytetarit komisioni i ngritur me urdhërin nr. 23, datë 22.01.2026, nr. 260 prot., datë 22.01.2026 i ndryshuar, me urdhërin nr. 156, nr. 2523 prot., datë 31.07.2026
Komisioni pasi bëri verifikimin në vend të dëmeve të shkaktuara nga rënia e zjarrit në banesën e z. Agur Alushaj mbajti procesverbalin me nr. 3369/1 prot., datë 22.10.2026. Nga procesverbali i verifikimit në vend rezulton se janë djegur (dëmtuar) :
Sobë elektrike, furrë pjekje, lavatriçe, tendë dielli ballkoni, xham dritare dural, suvatim meremetje, bojatisje.
U hartua edhe preventivi për punimet që duhet të kryhen në banesë për reabilitim në vlerën 162,780 lekë, referuar edhe "Vërtetimit për rënie zjarri" nr. 9, të datës 16.10.2026 lëshuar nga MZSH Patos që vërteton rënien e zjarrit.
Në bazë të V.K.M-së nr. 329, datë 16.5.2012, "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore" të dëmtuarit i jepet ndihmë financiare deri në masën 50% e vlerës.
Bazuar në V.K.M-në nr. 414, dt. 08.07.2021 "Për miratimin e procedurave dhe kritereve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile" (i ndryshuar) pika 3.1 shkronja "a" me qëllim për të ndihmuar qytetarin z. Agur Alushaj, banesa e të cilit është dëmtuar nga rënia e zjarrit, t'i jepet një ndihmë financiare në vlerën 80,000 lekë.
Lori Musaj- Komisioni ekonomisë u mblodh dhe është diskutuar mbi këtë pikë e cili është votuar me tre vota pro.
Armand Ahmetaj- Keni ndonjë diskutim tjetër?
Armand Ahmetaj – Nëse s'kemi pyetje të tjera unë propozoj ta kalojmë në votim pikën e shtatë Kush është dakord?
Miratohet me 11 vota pro, abstenim ska, kundër ska

SEKRETARE
Refaela Xeba

KRYETAR
Armand Ahmetaj

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr.3184/2 **Prot.** **Patos më** 03 **11.2026.**

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 29.10.2026 në orën 14:00 në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së tetë të rendit të ditës.

Kërkesë nr. 3184, datë 02.10.2026 për dhënie ndihme të menjëhershme.

Albiona Lamaj- Sipas procesverbalit dhe shkresave që na kanë ardhur me email por që na janë bërë dhe të ditur në komisionin e shëndetësisë, kërkesa e z. Neim Ballaxhia për bashkëshorten Elisabeta Ballaxhia është në përputhje me rregulloren e miratuar nga këshilli bashkiak pasi janë dy diagnoza, bëjnë pjesë në diagnoza terminale është CA ventrikuli stomaku dhe limfoma Non Hodgkin ose CA e gjakut. Kështu që në këtë rast duhet ta kalojmë sezbën dhe në urgjencë nga këshill8i bashkiak dhe ti vijmë sadopak në ndihmë zonjës në fjalë duke qënë se është dhe pjesë e bashkisë Patos prej shumë vitesh duke dhënë kontributin e saj në pozicionin e punës që ka por edhe përsa i përket pjesës së buxhetit ne si këshill ose si komsion që jemi mbledhur mendoj që si cdo herë të tjera që kemi dhënë në rastet në fjalë shuma të jetë 150 mijë lëkë të reja.

Armand Ahmetaj –Nëse s'kemi pyetje të tjera unë prpozoj ta votojmë menjëherë pikën e tetë.
Kush është dakord?
Miratohet me 11 vota pro, abstenim ska, kundër ska.

SEKRETARE
Refaela Xeba

KRYETAR
Armand Ahmetaj